

Vendim nr. 40 datë 01.03.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Genti Ibrahimimi,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 01.03.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 15 (Gj) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: GJON MARKU, përfaqësuar nga avokat Gëzim Ndoj.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 316, datë 29.07.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; nr. 93, datë 09.02.2017 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2023-65, datë 13.01.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Dërgimi i çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, pika 1, 27, 29, 42, 43, 44, 49, pika 2, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27 e vijues, 71 e 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. 316, datë 29.07.2015, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit Gjon Marku për veprën penale “Dhuna në familje”, të parashikuar nga neni 130, shkronja “a”, pika 1, të Kodit Penal (KP). Gjykimi është zhvilluar sipas procedurës së gjykimit të shkurtuar dhe në përfundim kërkuesi është dënuar me 6 muaj burgim. Referuar përmbajtjes së vendimit, vuajtja e dënimit ka filluar më 22.05.2015, që është data e ndalimit të kërkuesit.

2. Ndaj vendimit ka paraqitur ankim avokatja A.T., e cila është pajisur me prokurë nga motra e kërkuesit. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 383, datë 26.09.2016, ka vendosur mospranimin e ankimit për shkak të moslegjitimitit të mbrojtësit për të bërë ankim, pasi kjo e drejtë nuk i ishte deleguar nga kërkuesi dhe e ka e orientuar atë për t’iu drejtuar gjykatës së shkallës së parë me kërkesë për rivendosjen në afat për të drejtën e ankimit.

3. Me vendimin nr. 243/52-2016-2967, datë 17.11.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, kërkuesi është rivendosur në afat për të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. 316, datë 29.07.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Pas paraqitjes së ankimit, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 93, datë 09.02.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 316, datë 29.07.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

4. Pas rekursit të ushtruar nga kërkuesi, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-65, datë 13.01.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmbante asnjërin prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale.

5. Kërkuesi në datën 05.12.2023, nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual sipas objektit, e cila, pas plotësimit të dokumenteve, është regjistruar përfundimisht në datën 28.12.2023.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se gjatë gjykimit është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar në nenin 42 të Kushtetutës, në drejtim të:

- 6.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka dëgjuar kërkuesin për pretendimet dhe nuk i ka shqyrtuar ato që lidheshin me shkeljen e ligjit.
- 6.2. *Së drejtës për t'u mbrojtur*, pasi konkluzionet përfundimtare në gjykimin në shkallë të parë dhe ankimi në apel nuk kanë qenë të nënshkruara nga kërkuesi, por nga avokati i zgjedhur nga familjarët. Shkelja është konstatuar e drejtë nga Gjykata e Apelit Shkodër, e cila e ka rivendosur në afat kërkuesin për të ushtruar të drejtën e ankimit.
- 6.3. *Mënyrës së marrjes së provave*, pasi gjatë veprimeve hetimore janë kryer shkelje të rënda procedurale, si gjatë dhënies së dëshmisë së djalit të mitur pa praninë e psikologut, ashtu dhe me nënshkrimin prej tij të procesverbalit të këqyrjes së telefonit të sekuestruar.
- 6.4. *Së drejtës për t'u dëshmipërblyer*, pasi veprimet fillestare në komisariatit e policisë Mirditë janë kryer në shkelje të ligjit dhe kjo ka sjellë arrestimin, dënimin dhe shkaktimin e dëmit të pariparueshëm shëndetësor e moral. Gjithashtu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka shkaktuar dëm si në personalitet, ashtu edhe në shëndet. Gjykata e Lartë nuk e ka vlerësuar dëmin moral, material të shkaktuar nga vendimet e padrejta, duke filluar që nga momenti i arrestimit, veprime që e kanë penguar në aktivitetin e punës dhe të botimeve.
- 6.5. *Së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, pasi Gjykata e Lartë ka shqyrtuar rekursin pas 5 vjetësh.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me

shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

8. Në këtë këndvështrim, Kolegji vlerëson se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, sepse është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

9. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Në nenin 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, përmbushja e këtij kriteri është detajuar në dy hipoteza: i) kur kërkuesi ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive përpara se t’i drejtohet Gjykatës; ii) kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete efektive në dispozicion.

10. Kërkuesi ka pretenduar, mes të tjerave, se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka zhvilluar një proces tej afatit të arsyeshëm ligjor, pasi rekursi është marrë në shqyrtim pas 5 vjetëve. Në lidhje me pretendimin për zhvillimin e një procesi tej afatit të arsyeshëm, dispozitat e Kodi të Procedurës Civile (KPC), që kanë qënë hyrë në fuqi në nëntor 2017, parashikojnë mjetet juridike për t’u mbrojtur nga cenimi i së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm. Konkretisht, në këto dispozita përcaktohet kuptimi i afateve të arsyeshme (neni 399/2), mjetet e mbrojtjes nga cenimi, kërkesa për përshpejtimin e gjykimit (neni 399/4), kërkesa për dëmshpërblim dhe kuptimi i shpërblimit të drejtë (neni 399/3), përcaktohet gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës (nenet 399/4 dhe 399/6), rregullat për gjykimin e kërkesës (neni 399/7), marrja e vendimit (neni 399/8) etj. Për rrjedhojë, ligji procedural ka parashikuar mjete juridike me qëllim që individit t’i garantohet mbrojtja efektive në lidhje me pretendimet për cenimin e së drejtës për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm.

11. Në rastin konkret, duke qënë se kërkuesi pretendon kohëzgjatje të paarsyeshme nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, nuk rezulton që ai t’i jetë drejtuar kësaj gjykate me kërkesë për konstatimin e gjykimit të çështjes tej afatit të arsyeshëm, sipas nenit 399/6, shkronja “c”, të KPC-së, ndaj, për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ai nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion për këtë pretendim.

12. Gjithashtu, në lidhje me pretendimet se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë shkaktuar dëm në personalitetin dhe në shëndetin e tij dhe se Gjykata e Lartë nuk ka vlerësuar dëmin moral, shëndetësor dhe dëmet e tjera për shkak të vendimeve të padrejta, nuk rezulton që kërkuesi t’u jetë drejtuar gjykatave të juridiksionit të zakonshëm me padi për kërkimet e tij, për rrjedhojë edhe për këtë pretendim nuk ka shteruar mjetet juridike efektive.

13. Për pretendimet e tjera, lidhur me cenimin e së drejtës për t’u mbrojtur gjatë gjykimit në gjykatën e apelit dhe për mënyrën e marrjes së provave, kërkuesi i ka paraqitur në formë e substancë në ankimin dhe rekursin ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, për rrjedhojë ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion. Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë, kërkuesi nuk ka mjete të tjera juridike në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë Kolegji vlerëson se ai i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

14. Në analizë të legjitimitetit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4-muj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Kolegji konstaton se vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar nga kërkuesi mban datën 13.01.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 05.12.2023, pra në dukje jashtë afatit ligjor.

15. Për sa i përket përmbushjes së këtij kriteri, kërkuesi ka pretenduar se ka marrë dijeni për vendimin në datën 03.08.2023, kur pas kërkesës së tij të datës 12.07.2023, Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, me shkresën nr. 719/1 prot., datë 03.08.2023, i ka vënë në dispozicion një kopje të vendimit të Gjykatës së Lartë.

16. Kolegji vëren se kërkuesi gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit Shkodër ka qenë i përfaqësuar me deklaram nga avokati Gëzim Ndoj, i cili ka paraqitur edhe ankimin kushtetues individual në Gjykatë. Nga përmbajtja e rekursit të ndodhur në dosjen gjyqësore e të paraqitur në Gjykatën e Lartë, rezulton se është i firmosur nga kërkuesi dhe nga avokati Gëzim Ndoj. Në rekurs, mes të dhënave, është vendosur adresa personale e postës elektronike dhe numri i telefonit të kërkuesit, si dhe adresa e postës elektronike të avokatit Gëzim Ndoj. Në ankimin kushtetues individual drejtuar Gjykatës kërkuesi nuk ka parashtruar asnjë pretendim në lidhje me mosnjohimin e vendimit nga Gjykata e Lartë si në adresën e postës elektronike personale, ashtu edhe në adresën elektronike të avokatit të tij.

17. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se si datë e fillimit të afatit ligjor 4-mujor për paraqitjen e tij, në rastin e

procesit gjyqësor, është data e marrjes dijëni efektivisht për vendimin gjyqësor që përbën mjetin e fundit ankimor. Kur objekt i ankimit kushtetues individual është një vendim i Gjykatës së Lartë, si datë e marrjes dijëni për vendimin gjyqësor është ajo kur vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare të saj ose përmes njoftimit elektronik të tij, kur palët kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit (*shih vendimet nr. 42, datë 19.09.2023; nr. 40, datë 14.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në vijim, referuar standardeve në lidhje me momentin e marrjes dijëni të vendimit të fundit objekt kundërshtimi, i është kërkuar Gjykatës së Lartë informacion për momentin e bërjes të disponueshëm të vendimit për palët. Sipas informacionit të ardhur nga Gjykata e Lartë me shkresën nr. 139/1 prot., datë 15.01.2024, rezulton se vendimi nr. 00-2023-65, datë 13.01.2023 është publikuar në faqen zyrtare të kësaj gjykate në datën 17.02.2023, datë kur palët mund ta dispononin atë.

19. Gjithashtu, nga materialet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllim të shqyrtimit kushtetues të çështjes, Kolegji konstaton se Gjykata e Lartë në datën 02.03.2023 i ka komunikuar avokatit Gëzim Ndoj vendimin në adresën e postës së tij elektronike, rrethanë të cilën Kolegji evidenton se ai nuk e ka parashtruar në ankimin kushtetues individual.

20. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se si datë për marrjen dijëni efektivisht për vendimin e Gjykatës së Lartë, objekt kundërshtimi, do të konsiderohet data 02.03.2023, kur fillon dhe llogaritja e afatit ligjor për ankimin kushtetues individual. Duke pasur parasysh se, sikurse u parashtrua më lart, ky i fundit është paraqitur në datën 05.12.2023, Kolegji çmon se kërkesa është jashtë afatit ligjor, për rrjedhojë kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis*.

21. Në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterit tjetër të pranueshmërisë që lidhet me legjitimitimin *ratione materiae* bëhet i panevojshëm, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

22. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “d” dhe “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.